



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



**Komuna Vushtrri**  
Opstina Vucitrn – Municipality of Vushtrri

---

**KOMISIONI PËR VLERËSIM TË OFERTAVE PËR PARK TË BIZNESIT NË  
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI**

Me datë: 06.05.2021

**N J O F T I M**

Në bazë të këtij Njoftimi dhe Vendimit për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës me nr të prot. 81/21 të dt. 16.04.2021 të Kuvendit Komunal për Vendosje në Parkun e Biznesit në Fshatin Lumadh-Vushtrri, ftohen të gjitha Bizneset e Aprovuara të cilat kanë plotësuar Kushtet dhe Kriteret e Përcaktuara me Vendim të Kuvendit Komunal të kompletojnë dokumentacionin si më poshtë:

1. Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës për përmbushjen e obligimeve tatimore;
2. Dëshminë nga ATK për numrin aktual të të punësuarve;
3. Planin e Biznesit (Detal) dhe
4. Garancionin bankar i cili duhet të jetë në shumën 5% të vlerës së investimit në Aplikacion/Ofertë siç është e përcaktuar edhe në Vendimin Nr.268/20 të dt. 30.12.2020 i cili mund të dorëzohet në një nga format e shënuara si në vijim:
  - a. Cek i vërtetuar nga një bankë e klasit të parë;
  - b. Letër krediti, të hapur dhe të konfirmuar nga një bankë e klasit të parë;
  - c. Garanci të pakushtëzuar bankare, të lëshuar nga një bankë e klasit të parë apo
  - d. Policë e sigurimit të lëshuar nga një Kompani e licencuar e sigurimeve.

*Vërejtje: Mospërmbushja e këtyre kritereve, të deklaruara në Aplikacion/Ofertë do të rezultoj me Refuzimin e Aplikacionit gjegjës dhe konfiskimin e Garancionit Bankar.*

Bizneset e Aprovuara nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë brenda afatit kohorë prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e shpalljes së këtij Njoftimi duhet të sjellin dokumentacionin e kërkuar si më sipër.